

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra, kryetar, dhe gjyqtarët profesionistë Shadije Gërguri dhe Shashivar Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Mybera Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës atëherë të Prokurorisë Publike të Qarkut – tani Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.219-2/2010 të dt.04.05.2010, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, me dt.16.01.2018, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Ferdane Sylejmani, i akuzuari B. M. dhe mbrojtësi i tij av.B. J., me dt.16.01.2018 mori, dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. M. me nofkën “L.”, i biri i H. dhe F., e gjinisë G., i lindur me dt.*data e lindjes...*, në fshatin M., komuna e P., ku edhe banon, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më datë **20.03.2010**, rreth orës **14:00**, në fshatin M., pikërisht, në lagjen B., komuna e P., në atë mënyrë që kur të dëmtuarit: Xh., F. dhe F. H. kanë shkuar në fshatin M., në shtëpinë e tyre të pabanuar, në mënyrë që të merren vesh me të pandehurin, për shkak se kanë dyshuar se në shtëpinë e tyre janë vjedhur disa gjësende dhe pas një mosmarrëveshje që kanë pasur mes veti, i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e tij e ka marr pushkën gjysëm automatike, me numër serik.PB-217, dhe është nisur në drejtim të veturës së të dëmtuarit F. H., me qëllim të kërcënimit me armë, por pasi që i dëmtuari F. nuk ka qenë në veturë, i pandehuri është kthyer në shtëpinë e tij, ndërsa me dt.14.04.2010, rreth orës 11:00, në të njëjtin vend policia ka shkuar në shtëpinë e të pandehurit që të bëjë kontroll, por i njëjti ka ikur në mal dhe pas largimit në një distancë prej 100m, ka shtënë dy herë me armë zjarri në ajër, më ç’rast policia janë tërhequr dhe në të njëjtën datë rreth orës 21:30 min., kanë shkuar përsëri në shtëpinë e të pandehurit për të bërë bastisjen dhe arrestimin e tij, me ç’rast është arrestuar i pandehuri, i cili pastaj ka pranuar se posedon armën e zjarrit gjysëmautomatike me numër serik PB-217 prodhim kinez, si dhe 7 plumba të kal.7.62mm., dhe të njëjtën e ka fshehur në mal rreth 150m, larg shtëpisë së tij të cilën armë e mbante pa autorizim, e që është konfiskuar nga policia.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së,

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 3, 34, 43 lidhur me 38, 64 dhe 328 par.1 dhe 5 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 dhe 463 të KPRK, e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit Xh., F. dhe F. H. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Të akuzuarit i konfiskohet një armë zjarri, pushka gjysëautomatike me nr.serik PB-217 prodhim kinez, si dhe 7 plumba të kal.7.62.mm., e cila i është konfiskuar përkohësisht nga ana e policisë, si mjet i kryerjes së veprës penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria atëherë Publike e Qarkut - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP.nr.219-2/2010 të dt.04.05.2010, kundër të akuzuarit B. M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, me dt.16.01.2018, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e veprës penale me të cilën akuzohet. Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e këtyre veprave penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit B. M., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e ka shpallë fajtor, dhe i'a shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se me vetë faktin se i akuzuari e pranoi fajësinë dhe se një pranim i tillë i fajësisë është në përputhshmëri me të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal të merrë si

rrethanë lehtësuese faktin se i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj propozon që ta shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. M. av.B. J. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh faktin se i mbrojturi i tij qysh në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, kërkon nga trupi gjykues i kësaj gjykate ti ketë parasysh disa rrethana lehtësuese me rastin e matjes dhe individualizimit të dënimit për të mbrojturin e tij, dhe ate pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese si dhe rrethanat tjera, si kohën e kaluar prej kur është kryer kjo vepër penale, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe i njëjti ka premtuar se nuk do ti përsëris veprimet e tilla në të ardhmen.

I akuzuari B. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë mbrojtësin e tij, është penduar për veprën penale të kryer, ka shprehur keqardhje për veprimin që ka bërë, duke premtuar se nuk do të përsërisë në të ardhmen veprime të tilla, e ka lutë gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim penal sa më të butë.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 64 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, vlerësoi faktin se të njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sigurtë, sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsërit asnjëherë këto veprime, të akuzuarit i'a shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 34 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarës, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin është marrë konform nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë duke pas për bazë faktin se të dëmtuarit nuk kanë qenë prezent në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e po ashtu deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e kanë precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesshëm lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.102/10, dt.16.01.2018

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.